



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 5
10.01.2013

NR. VENDIMI 3
10.04.2013

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane në trup gjyqësor të përbërë prej gjyqtarëve:

*Kryesuese : Flora HAJREDINAJ
Anetar : Gurali BRAHIMLLARI
Anetar : Idriz MULKURTI*

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Fjoralba KOLA, sot në datën 10.04.2013, perfundoi se shqyrtuari në seance gjyqësore publike kërkesën nr.05 akti që i përket :

PADITËS: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, perfaqësuar në gjykim nga prokurori Eneë NAKUCI.

ME OBJEKT:

Konfiskimin e pasurive të paluajtshme, e llojit apartament, ndodhur në lagjen “xxx” pallati xx, shkalla x; me nr. Xxx, regjistruar në volumn nr.xx; faqe xxx zona kadastrale xxx; me sipërfaqe xx m² si edhe të sipërfaqes prej xx m², e shtuar pas rikonstruksionit. Në total kjo pasuri është presj xx(xxx) m², e cila aktualisht funksionon me emrin club “xxx”se bashku me të gjithë pajisjet e lokalit.

I PADITUR: G.(A.) C., i biri i A. dhe i A., i datelindjes xxx, lindur dhe banues në xxx lagja “xxx”, pallati nr.xxx, gjykuar në mungesë, perfaqësuar në gjykim nga perfaqësuesi i zgjedhur me prokuror nr.xx rep. dhe xx kol date xxx av.A.P.

PERSONI TRETË: I.C. i biri i A. dhe i A., i datelindjes xxx, lindur dhe banues ne xxx lagja "xxx", pallati nr.xxx. (person i lidhur me G.(A.) C., vëllai i tij), gjykuar ne mungese, perfaqesuar ne gjykim nga perfaqesuesi me prokure nr xxx rep dhe xxx kol date xxx si dhe i zgjedhur edhe me deklarim ne séance gjyqesore, av. A.P.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.10192 date 03/12/2009 "Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise".

Ne perfiundim te shqyrtimit gjyqesor, te zhvilluar sipas rregullave te procedures civile, ne prani te:

- Perfaqesuesit te paditesit, prokurorit Ened Nakuçi i cili hoqi dore nga gjykimi i padise per konfiskimin e pasurise ne emer te shtetasve G.(A.) C., I.C. dhe revokimin e sekuestros per pronat e sekuestruara si:

-Pasuri e paluajtshme, e llojit apartament, ndodhur ne lagjen "xxx"pallati xx shkalla x; me nr xxx rregjistruar ne volumin nr.xx; faqe xxx zona kadastrale xxx; me siperfaqe xx m2 si edhe te siperfaqes prej xx m2, e shtuar pas rikonstruksionit. Ne total kjo pasuri eshte presj xx(xxx) m2, e cila aktualisht funksionon me emrin club "xxx"se bashku me te gjithë pajisjet e lokalit.

-Perfaqesuesit te te paditurit G.(A.) C. dhe personit te trete I.C. av.A.P. qe kerkoi: Pushimin e gjykimit per konfiskimin e pasurive, revokimin e sekuestros se vendosur ndaj tyre,

Gjykata, pasi degjoi kerkimet e paleve dhe shqyrtoi aktet e paraqitura:

V E R E N s e:

Prokuroria per Krime te Renda Tirane ka paraqitur para kesaj gjykate ne daten xxx nje kerkesepadi per konfiskimin e pasurive te shtetasit G.(A.) C. dhe personit te trete I.C. duke pretenduar se jane subjekte te hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 date 03.12.2009 "Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise" dhe pasurite e zoteruara nuk i pergjigjen nivelit te te ardhurave dhe fitimeve te tyre.

Kete kërkesepadi, Prokuroria prane Gjyqates se Shkalles se Pare per Krime te Renda e ka paraqitur pas pranimit nga Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane me vendimin e saj nr.xx date xxx te kërkeses per sekuestrimin e pasurise se poshteshenuar:

-pasuri e paluajtshme, e llojit apartament, ndodhur ne lagjen “xxx” pallati xx, shkalla x; me nr. xxx, rregjistruar ne volumin nr.xx; faqe xxx zona kadastrale xxx; me siperfaqe xx m2 si edhe te siperfaqes prej xx m2, e shtuar pas rikonstruksionit. Ne total kjo pasuri eshte presj xx (xxx) m2, e cila aktualisht funksionon me emrin club “xxx”se bashku me te gjithë pajisjet e lokalit.

Keto veprime, kanë filluar pas rregjistrimit ne daten xxx, ne Prokurorine per Krime te Renda te procedurave per hetim pasuror ndaj shtetasit G.(A.) C., per arsye se me date xxx i padituri G.(A.) C.) eshte marre si i pandehur, per vepren penale te “Shfrytezimit te prostitucionit ne rrethana renduese” sipas nenit 114/a pika 5 te Kodit Penal. Me vendimin penal nr.xxx date xxx, Gjykata e Rrethit Gjyqesor xxx e ka deklaruar fajtor dhe denuar perfundimisht me x(xxx) vjet e x(xxx) muaj burgim.

Ne kërkesen per konfiskim te rregjistruar prane kesaj gjyqate ne date xxx prokurori, kërqoi konfiskimte pasurise se sekuestruar, sipas vendimit te sipercituar te Gjyqates se Shkalles se Pare per Krime te Renda.

*Ne seancen gjyqesore te dates xxx qe ishte dhe seanca gjyqesore e bisedimeve perfundimtare prokurori Ened Nakuçi qe perfaqeson palen paditese, Prokurorine prane Gjyqates se Shkalles se Pare per Krime te Renda ne kete gjykim, me arsyetimin se gjate gjykimit nuk u be e mundur te provohet se kjo pasuri eshte fituar me veprimtari te jashteligjshme, **hoqi dore nga gjykimi i padise per konfiskimin e pasurive ne emer te shtetasve G.(A.) C. dhe I.C. dhe revokimin e sekuestros per pronen e sekuestruar si:***

-pasuri e paluajtshme, e llojit apartament, ndodhur ne lagjen “xxx” pallati xx, shkalla x; me nr. xxx, rregjistruar ne volumin nr.xx; faqe xxx zona kadastrale xxx; me siperfaqe xxm2 si edhe te siperfaqes prej xxm2, e shtuar pas rikonstruksionit. Ne total kjo pasuri eshte prej xx(xxx) m2, e cila aktualisht funksionon me emrin club “xxx”se bashku me te gjithë pajisjet e lokalit.

Perfaqesuesi i te paditurit G.(A.) C. dhe dhe personit te trete I.C., av A.P., pas heqjes dore te prokurorit nga gjykimi i padise per konfiskimin e kesaj pasurie, kerkoi pushimin e gjykimit, revokimin e sekuestros se vendosur ndaj pasurise se sipercituar.

Gjykata vlereson se pas heqjes dore te pales paditese nga gjykimi i padise per konfiskimin e pasurise, duhet te vendose pushimin e ketij gjykimi per konfiskim te pasurive ne emer te te paditurit G.(A.) C.) dhe personit te trete I.C. per arsye se:

Neni 201 i Kodit te Procedures Civile ne paragrafin e tij te pare parashikon se:

“Paditesi ne cdo faze te gjykimit mund te heqe dore nga gjykimi i padise. Ne kete rast gjykata vendos pushimin e gjykimit.”

E gjendur ne kete rrethane, gjykata mbi kerkimin e paditesit dhe parashikimin e nenit 201/1 te Kodit te Procedures Civile, vendos pushimin e gjykimit te padise qe lidhet me kerkesen per konfiskimin e pasurise se paluajtshme, e llojit apartament, ndodhur ne lagjen “xxx” pallati xx, shkalla x; me nr xxx; regjistruar ne volumin nr.xx; faqe xxx; zona kadastrale xxx; me siperfaqe xxm2 si edhe te siperfaqes prej xxm2, e shtuar pas rikonstruksionit. Ne total kjo pasuri eshte prej xx(xxx) m2, e cila aktualisht funksionon me emrin club “xxx”, se bashku me te gjitha pajisjet e lokalit.

Lidhur me masen e sekuestros se vendosur mbi pasurine e cituar me siper, e gjendur ne kushtet kur pala paditese, prokurori, kerkoi heqjen dore nga gjykimi i padise per konfiskimin e saj, pushojne dhe efektet e sekuestrimit te tyre, ne kuptim te nenit 12/5 te ligjit nr.10192 date 03.12.2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”. Per kete arsye, Gjykata vendos revokimin e mases se sekuestros se vendosur mbi keto pasuri me vendimin e saj nr.xx date xxx.

Per ekzekutimin e ketij vendimi, ne perputhje me nenin 14 te ligjit nr. 10192, date 03/12/2009 urdherohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor xxx dhe vihen ne dijeni administratorja znj.D.B., e cila eshte caktuar per administrimin dhe perdorimin e pasurive te sekuestruara, administratore prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave xxx.

PER KETO ARSYE:

Gjykata, bazuar ne nenin 201 e vijues te Kodit Procedures Civile Civile dhe ligjit nr.10192, date 03.12.2009 "Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise",

V E N D O S I:

-Pushimin e gjykimit te padise se paditesit, Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda per Krime te Renda Tirane, qe lidhet me kerkesen per konfiskimin e pasurise se paluajtshme, e llojit apartament, ndodhur ne lagjen "xxx" pallati xx, shkalla x; me nr xxx, rregjistruar ne volumin nr.xx; faqe xxx zona kadastrale xxx; me siperfaqe xx m2 si edhe te siperfaqes prej xx m2, e shtuar pas rikonstruksionit. Ne total kjo pasuri eshte xx(xxx) m2, e cila aktualisht funksionon me emrin club "xxx", se bashku me te gjithe pajisjet e lokalit.

-Revokimin e mases se sekuestros se vendosur me vendimin nr.xx date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane mbi pasurine e mesiperme.

-Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit Elbasan.

-Urdherohet sekretaria gjyqesore e kesaj gjykate te njoftoje per kete vendim administratoren prane Agjencise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave xxx znj.D.B., e caktuar per administrimin dhe perdorimin e pasurise se sekuestruar.

- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda brenda afatit ligjor.

-U shpall ne Tirane, sot me date 10.04.2013, ora 10.35

S E K R E T A R E

Fjoralba KOLA

G J Y Q T A R E

Flora HAJREDINAJ